

## ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT

Sipas Nenit 109 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092

Një ankesë kundër: **MINISTRIA E ARSIMIT**

Nr i Prokurimit **208-25-10238-5-1-1**

Sa i përket tenderit për **Ndërtimi i Çerdhes në lagjen M ATI-1. Prishtinë**

### ANKESË

#### 1. Identifikimi i ankuesit\*

**NNP"CTA"shpk&"U - UNIQUE" SH. P. K.**  
(Shëno emrin e plotë të kompanisë suaj)

**rr.Mehmet Gradica hy2 nr6**  
(Adresa)

**Prishtine**

**10000**

(Vendi)

(Kodi postar)

**+383-44-507719**  
(Numri Telefonit)

(Numri)

**ZIJA MORINA**

(Emri i plotë i përfaqësuesit të kompanisë suaj)

[nnpcta@gmail.com](mailto:nnpcta@gmail.com)

(Adresa elektronike)

**08.06.2026**

(Data e parashtrimit të ankesës)

(Nënshkrimi dhe vula)



\*Ankues do të thotë një palë e interesuar për parashtrim të ankesës.

## 2. Identifikimi i avokatit

Parashtruesi i ankesës mund ta parashtroj ankesën vetëm ose përmes avokatit të tij. Nëse ankesa parashtrohet përmes avokatit, atëherë duhet bashkangjitur autorizimin e përfaqësimit me PROKURË.

Shëno të dhënat si në vijim:

(Emri i avokatit)

(Adresa e plotë)

(Numri i Telefonit)

(Numri i faks-it)

(Adresa elektronike)

(Data e parashtrimit të ankesës)

(Nënshkrimi dhe vula)

## 3. Të dhënat mbi aktivitetin e prokurimit

[Shëno një përshkrim të shkurtër lidhur me datën dhe vendin në të cilën është publikuar “ Njoftimi për Kontratë” apo “Njoftimi për konkurs të projektimit” dhe, nëse aplikohet “Njoftimi për dhënie të Kontratës”, “Njoftimi për Rezultatet e Konkursit të Projektimit” apo “Njoftimi për anulim të aktivitetit të prokurimit”, nëse aplikohet, afatin e fundit për dorëzimin e tenderit, datën dhe orën e fillimit të procesit për Hapjen e Tenderëve, si dhe kriteri për dhënie të kontratës].

Ky aktivitet i prokurimit ka të bëjë me tenderin: : **Ndërtimi i Çerdhes në lagjen M ATI-1. Prishtinë** Njoftimi për kontrate është bërë me datën **08.11.2025** dhe hapja publike është bërë me datën **19.12.2025**. Njoftimi për Vendimin e Autoritetit Kontraktues lidhur me procesin e vlerësimit është publikuar me datë **22.05.2026** ndërsa edhe njoftimin për tenderusin e pasukseshem na është dërguar me datën **22.05.2026**. Kriteri për dhënie të kontratës ka qenë: Tenderi i përgjegjshëm me çmim më të ulët

## 4. Procesi i Hapjes së tenderëve, nëse aplikohet

A keni marrë pjesë në procesin e Hapjes së tenderëve? Nëse po, specifikoni shkurtimisht ecurinë e procesit të Hapjes së Tenderëve.

Po

Jo

Hapja është bërë në platformën e prokurimit

## 5. Njoftimi mbi Eliminimin e Tenderuesve, nëse aplikohet

A jeni njoftuar me shkrim lidhur me eliminimin tuaj nga pjesëmarrja e mëtutjeshme në aktivitetin e prokurimit ?

Po

Jo

## 6. Zgjidhja preliminare e mosmarrëveshjeve

*A keni bërë kërkesë për rishqyrtim pranë AK lidhur me arsyet e eliminimit tuaj?*

Po

Jo

Më datë **22.05.2026**, Autoriteti Kontraktues ka publikuar **Njoftimin për Dhënie të Kontratës** lidhur me aktivitetin e prokurimit të lartcekur.

Në përputhje me dispozitat e Ligjit për Prokurimin Publik, më datë **29.05.2026**, GOE Ankues ka parashtruar **Kërkesë për Rishqyrtim** pranë Autoritetit Kontraktues kundër Njoftimit për Dhënie të Kontratës.

Gjatë llogaritjes së afateve duhet të merren parasysh këto rrethana: më date

**27.05.2026** ka qenë ditë feste zyrtare, përkatësisht Festa e Bajramit, ndërsa më datë **28.05.2026** platforma e e-Prokurimit nuk ka qenë funksionale. Për këtë çështje ekziston njoftim zyrtar, sipas të cilit janë shtyrë për një ditë të gjitha afatet që lidhen me paraqitjen e ankesave, kërkesave për rishqyrtim, dorëzimin e tenderëve dhe veprimet tjera në platformën e e-Prokurimit.

Më datë **03.06.2026 në ora 16:12**, Autoriteti Kontraktues ka dërguar njoftim për shtyrje të afatit për shqyrtimin e kërkesës për rishqyrtim.

Më datë **04.06.2026**, Autoriteti Kontraktues ka nxjerrë/dërguar vendim lidhur me kërkesën për rishqyrtim, me të cilin ka refuzuar kërkesën e GOE Ankues dhe ka lënë në fuqi **Njoftimin mbi Vendimin e Autoritetit Kontraktues / Njoftimin për Dhënie të Kontratës**.

Meqenëse afati ligjor prej **dhjetë (10) ditësh** për paraqitjen e ankesës në OSHP, i llogaritur nga data e paraqitjes së kërkesës për rishqyrtim, skadon sot në **ora 16:00**, GOE Ankues paraqet këtë ankesë brenda afatit ligjor, me qëllim të ruajtjes së të drejtës për ankesë.

Prandaj, në përputhje me LPP-në dhe brenda afatit ligjor, GOE Ankues i drejtohet OSHP-së me këtë ankesë kundër vendimit të Autoritetit Kontraktues lidhur me kërkesën për rishqyrtim, si dhe kundër Njoftimit për Dhënie të Kontratës të datës **22.05.2026**.

## 7. Dispozitat e shkelura nga Autoriteti Kontraktues

*Specifikoni dispozitën ose dispozitat e LPP-së që supozohet të jenë shkelur nga Autoriteti Kontraktues që nga momenti i publikimit të Njoftimit për Kontratë/Konkurs të Projektimit, dhe nëse aplikohet gjerë në përmblylljen e këtij aktiviteti të prokurimit me publikimin e Njoftimit për Dhënien e Kontratës apo Njoftimit për Rezultatet e Konkursit të Projektimit apo Njoftimit për Anulim.*

AK gjate vlerësimin dhe krahasimin të tenderëve nuk ka zbatuar me përpikëri të gjitha dispozitat e Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092. Përpos kësaj AK nuk ka respektuar as kërkesat e dosjes së tenderit të cilat vetë i ka parashtruar në fillim të këtij procesi të prokurimit. Dispozitat që ne mendojmë se AK i ka shkelur janë:

- **Neni 5 i LPP-së**
- **Neni 7 i LPP-së**
- **Neni 10 i LPP-së**
- **Neni 11 i LPP-së**
- **Neni 59 paragrafi 1 i LPP-së**
- **Neni 59 paragrafi 4 i LPP-së**
- **Neni 60 i LPP-së**
- **Neni 69 i LPP-së**
- **Neni 72 i LPP-së**
- **Neni 108/A paragrafi 6 të LPP**
- **Neni 61.1 të Rregullores Nr.001/2022 për Prokurimin Publik**
- **Neni 40.2 i Rregullores nr. 001/2022**
- **Neni 40.13 i Rregullores nr. 001/2022**
- **Neni 30.4 i Rregullores nr. 001/2022, e ndryshuar/plotësuar me Rregulloren nr. 002/2024**
- **Neni 7.6.2 i Rregullores nr. 002/2024**
- **Neni 7.6.3 i Rregullores nr. 002/2024**

*\*\* Sipas Nenit 118 të LPP, OSHP-ja do të kthejë tarifën tuaj nëse ankesa aprovohet si e bazuar. OSHP-ja mund të kërkojë një gjorbë shtesë deri në 5,000 Euro në rastet kur OSHP-ja konstaton që të gjitha apo cilado nga pretendimet e parashtruara në ankesë kanë qenë të rrejshme ose mashtruese.*

## **8. Deklaratë detale mbi faktet dhe argumentet**

*Përshkruani rrethanat faktike që përbëjnë supozimin për shkeljen e dispozitave të LPP-së. Ofroni deklaratë të qartë dhe të detajuar për faktet dhe argumentet të cilat mbështesin secilën bazë të ankesës tuaj.*

**Njoftim mbi vendimin e Autoritetit Kontraktues, datë 22.05.2026 mbi tenderuesin e sukseshëm GOE "AC-ing" SH.P.K. & "Decon" SH.P.K., në vlerë prej 1,121,999.97 euro**  
Me datë 22.05.2026, Autoriteti Kontraktues ka lëshuar **Letrën Standarde për Tenderuesin e Pasuksesshëm per NNP"CTA"shpk&"U - UNIQUE" SH. P. K.**

Me datë 25.05.2026 kemi kërkuar qasje në dokumentacionin e tenderit, ndërsa Autoriteti Kontraktues na ka mundësuar qasje me datë 26.05.2026. Megjithatë, qasja nuk ka qenë e plotë, pasi na është ofruar vetëm dokumentacioni i GOE-së së shpallur fitues, por jo edhe dokumentacioni i operatorëve ekonomik që kanë pasur çmim më të ulët se oferta jonë.

Pas kësaj, kemi kërkuar përsëri qasje të plotë, mirëpo Autoriteti Kontraktues nuk na ka ofruar dokumentacionin e kërkuar. Kjo na ka pamundësuar verifikimin e ligjshmërisë së vlerësimit dhe krahasimit të ofertave.

## **Pretendimi nr. 141**

GOE Ankues kundërshton si të pabazuar konstatimin e Autoritetit Kontraktues se kërkesa për rishqyrtim është paraqitur jashtë afatit ligjor.

Autoriteti Kontraktues pretendon se Njoftimi mbi Vendimin e AK-së/B58 është publikuar më **22.05.2026** dhe se afati për paraqitjen e kërkesës për rishqyrtim ka përfunduar më **27.05.2026**, përkatësisht më së largu më **28.05.2026 në ora 16:00**.

Ky konstatim është i pasaktë.

Sipas **nenit 60.1 pika b të Rregullores Nr.001/2022 për Prokurimin Publik**, kur kërkesa për rishqyrtim ka të bëjë me vendimin për dhënie të kontratës, ajo paraqitet brenda afatit prej **pesë (5) ditëve** pas datës së publikimit të Njoftimit mbi Vendimin e AK-së/B58, ndërsa dita e publikimit konsiderohet **dita zero**.

Llogaritja e afatit është si vijon:

**22.05.2026** – dita zero;

**23.05.2026** – dita e parë;

**24.05.2026** – dita e dytë;

**25.05.2026** – dita e tretë;

**26.05.2026** – dita e katërt;

**27.05.2026** – dita e pestë. Sipas kalendarit të festave zyrtare në Kosovë për vitin 2026, data **27 maj 2026** ka qenë ditë feste zyrtare përkatësisht Fesat e **Kurban Bajramit**.

**28.05.2026** – platforma e **e-Prokurimit** nuk ka qenë funksionale



rks-gov.net · rks-gov.net

Contact info



038 213 796



publikimet.krpp@rks-gov.net



Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik / PPRC

Photos

See all photos



Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik / PPRC

May 28 at 10:43 AM · 🌐

📢 N J O F T I M P Ë R O E dhe AK

Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik (KRPP) njofton të gjithë Operatorët Ekonomik dhe Autoritetet Kontraktuese se për arsye të problemeve teknike, aktualisht apo sot me datë 28/05/2026 Sistemi i Prokurimit Elektronik është i pa qasshem nëpërmjet linkut <https://e-prokurimi.rks.gov.net>

Prandaj, në pajtim me RRPP, paragrafi 33.14, KRPP do të ndërmarrë veprimet teknike në sistemin e prokurimit elektronik – duke bërë ndalimin e hapjeve të ofertave për të gjitha aktivitetet e prokurimit me datë të hapjes 28/05/2026 dhe do të obligoj të gjitha AK-të që të vepronin në pajtim me RRPP paragrafi 33.14 dhe nën-paragrafet përkatëse për të bërë zgjatjen e afatit të dorëzimit të ofertave/aplikacioneve për të gjitha aktivitetet e prokurimit me datë të hapjes 28/05/2026.

Aplikimi i ndalimit të hapjes së ofertave dhe zgjatjes së afatit për dorëzimin e ofertave/aplikacioneve për aktivitetet e prokurimit me datë të hapjes së ofertave në datat e përveç datës 28/05/2026, do të jetë në varësi të kohëzgjatjes së problemit teknik.

Gjithashtu, në varësi të zgjatjes së problemit teknik do të merret vendim edhe për zgjatjen e afatit të ofertave kohore që kanë të bëjnë me kërkesa për rishqyrtim, ankesa apo çfarëdo veprimi të ndërlidhur me afate kohore të caktuara.

Lidhur me rregullimin e problemit teknik dhe veprimet që do të ndërmerren, KRPP do të informuar të gjithë OE, AK dhe palët e interesuara. [See less](#)

👍 7

👍 Like

💬 Comment

➦ Share



Write a comment...



Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik / PPRC

May 22 at 2:31 PM · 🌐

📢 KRPP pjesë e lansimit të procesit për Vlerësimin e Rrezikut të Korrupsionit në Prokurimit Publik... [See more](#)



- FILLIMI
- RRETH NESH
- LEGJISLACIONI
- MANUALET
- INFORMACIONE
- TRAJNIMET
- RAPORTET
- KONTAKTET

Shqip Login

- HYRJE (LOGIN)
- REGJISTRIMI
- NJOFTIMET - PROKURIMET
- NJOFTIMET - SHITJE
- KONTRATAT E DHËNA
- MARRËVESHJET KORNIZË E DHËNA
- KLASIFIKIMI LIGJOR

NJOFTIM I PËRDITËSUAR PËR OE dhe AK

NJOFTIM I PËRDITËSUAR PËR OE dhe AK  
Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik (KRPP) njofton të gjithë Operatorët Ekonomik dhe Autoritetet Kontraktuese se problemi teknik i datës 28.05.2026 për qasje në Sistemin e Prokurimit Elektronik nëpërmjet linkut <https://e-prokurimi.rks.gov.net> është zgjidhur dhe sistemi është në operim dhe funksional.  
Ashtu siç është njoftuar me njoftimin paraprak, është bërë ndalja e hapjes së ofertave për të gjitha aktivitetet e prokurimit me datë të hapjes 28.05.2026, ndërsa AK-se janë të obliguara që nëpërmjet korigjimit të procedurës të bëjnë shtyrjen e afatit kohor për hapje të ofertave në shtytshmëri me udhëzimet e RRPP.  
Gjithashtu, proporcionalisht me zgjatjen e problemit, afatet kohore të përcaktuara me datë 28.05.2026 do të shtyhet për datën 29.05.2026 - për kërkesa për rishqyrtim, ankesa apo çfarëdo veprimi të ndërlidhur me afate kohore të caktuara.

Back  
Gjithashtu, proporcionalisht me zgjatjen e problemit, afatet kohore të përcaktuara me datë 28.05.2026 do të shtyhet për datën 29.05.2026 - për kërkesa për rishqyrtim, ankesa apo çfarëdo veprimi të ndërlidhur me afate kohore të caktuara.

Mirëpo, data **27.05.2026**, që ishte dita e fundit e afatit, ka qenë ditë feste zyrtare. Sipas **nenit 5 paragrafi 2 të LPP-së**, kur dita e fundit e afatit bie në festë zyrtare, afati zgjatet deri në ditën e parë të punës pas saj.

Për këtë arsye, afati nuk ka përfunduar më **27.05.2026**, por është bartur në ditën pasuese të punës, më **28.05.2026**.

Për më tepër, më **28.05.2026**, platforma e **e-Prokurimit** nuk ka qenë funksionale. Për këtë çështje ka ekzistuar njoftim zyrtar, sipas të cilit afatet për paraqitjen e ankesave, kërkesave për rishqyrtim, dorëzimin e tenderëve dhe veprimet tjera në platformë janë shtyrë për një ditë.

**Rrjedhimisht, afati për paraqitjen e kërkesës për rishqyrtim ka përfunduar më 29.05.2026 në ora 16:00.**

GOE Ankues e ka dorëzuar kërkesën për rishqyrtim më **29.05.2026 në ora 11:48**, pra para përfundimit të afatit.

Prandaj, kërkesa për rishqyrtim është paraqitur brenda afatit ligjor, ndërsa konstatimi i Autoritetit Kontraktues se kërkesa është e pasafatshme është i pabazuar dhe duhet të refuzohet nga OSHP.

### **Pretendimi nr. 142**

GOE Ankues pretendon se Autoriteti Kontraktues ka vepruar në kundërshtim me **nenin 5 dhe nenin 108/A paragrafi 6 të LPP-së**, pasi nuk ka nxjerrë vendim lidhur me kërkesën për rishqyrtim brenda afatit ligjor prej **tre (3) ditësh pune**.

Kërkesa për rishqyrtim është dorëzuar më **29.05.2026 në ora 11:48**. Dita e dorëzimit konsiderohet dita zero, ndërsa datat **30.05.2026** dhe **31.05.2026** nuk llogariten, pasi janë ditë jopune.

Afati ligjor prej tre ditësh pune është llogaritur si vijon:

**01.06.2026** – dita e parë e punës;

**02.06.2026** – dita e dytë e punës;

**03.06.2026** – dita e tretë dhe dita e fundit e afatit.

Sipas **nenit 5 të LPP-së**, afati ka përfunduar më **03.06.2026 në ora 16:00**.

Brenda këtij afati, Autoriteti Kontraktues nuk ka nxjerrë vendim lidhur me kërkesën për rishqyrtim. Përkundrazi, Autoriteti Kontraktues ka dërguar vetëm njoftim për shtyrje të afatit më **03.06.2026 në ora 16:12**, pra **12 minuta pas skadimit të afatit ligjor**.

Më pas, Autoriteti Kontraktues ka publikuar/dërguar vendimin lidhur me kërkesën për rishqyrtim më **04.06.2026 në ora 15:36**, pra në **ditën e katërt të punës**, pas skadimit të afatit ligjor prej tre ditësh pune.

Prandaj, vendimi i Autoritetit Kontraktues është nxjerrë jashtë afatit ligjor, ndërsa njoftimi për shtyrje është i vonuar dhe nuk mund të prodhojë efekt juridik, pasi një afat i skaduar nuk mund të zgjatet pas përfundimit të tij.


## Kërkesë

GOE Ankues kërkon nga OSHP që:

1. Të konstatojë se Autoriteti Kontraktues ka vepruar në kundërshtim me **nenin 5 dhe nenin 108/A paragrafi 6 të LPP-së**;
2. Të konstatojë se njoftimi për shtyrje i datës **03.06.2026, ora 16:12**, është bërë pas skadimit të afatit ligjor;
3. Të konstatojë se vendimi i Autoritetit Kontraktues i datës **04.06.2026, ora 15:36**, është nxjerrë pas afatit ligjor prej tre ditësh pune;
4. Të vërtetojë se njoftimi i vonuar për shtyrje nuk prodhon efekt juridik;
5. Të pranojë si të bazuar këtë pretendim ankimor.

**Prova 1:** Dëshmia nga platforma e-prokurimi, ku shihet se njoftimi për shtyrje është publikuar/dërguar më **03.06.2026 në ora 16:12**.

**Prova 1:** Dëshmia nga platforma e-prokurimi, ku shihet publikimi/dërgimi i njoftimit për shtyrje më **03.06.2026 në ora 16:12**.



**Prova 2:** Shkresa/Formulari B47 i Autoritetit Kontraktues për shtyrje të afatit, e datës **03.06.2026, ora 16:12**.

## NJOFTIM

### Për shtyrjen e afatit për shqyrtimin e ankesës

<b>PËR:</b>	OE NNP CTA SH.P.K. i
<b>SUBJEKTI:</b>	Njoftim për tri (3) ditë shtesë për përgjigje dhe shqyrtim të ankesës
<b>REFERENCË:</b>	Ankesa e parashtruar lidhur me procedurën përkatëse të prokurimit: Ndërtimi i Çerdhes në lagjen M ATI-1, Prishtinë

Të nderuar,

Autoriteti Kontraktues, lidhur me ankesën e parashtruar nga Operatori Ekonomik / palët e interesuara në procedurën përkatëse të prokurimit, ju njofton se afati për shqyrtimin e ankesës dhe për dhënien e përgjigjes zyrtare vazhdohet edhe për tri (3) ditë shtesë.

Shtyrja e afatit bëhet për arsye se për shkak të vëllimit të madh të punëve dhe nevojës për shqyrtim të plotë,

Pas përfundimit të shqyrtimit, Autoriteti Kontraktues do t'ju njoftojë me shkresë / përgjigje zyrtare brenda afatit të vazhduar.

Ky njoftim bëhet me qëllim të informimit tuaj me kohë dhe të sigurimit të trajtimit transparent të ankesës.

Me respekt,

**MINISTRIA E ARSIMIT, SHKENCËS,  
TEKNOLOGJISË DHE INOVACIONIT**

Divizioni / Njësia e Prokurimit Publik

**Prova 3:** Dëshmia nga platforma e-prokurimi, ku shihet se vendimi i AK-së për kërkesën për rishqyrtim është publikuar/dërguar më **04.06.2026 në ora 15:36**.

The screenshot displays a list of documents and decisions in a table format. The entry for 'Vendimi i AK në Kërkesën për rishqyrtim' dated 04.06.2026 at 15:36 is highlighted with a red box. A red note indicates the decision was made on 04.06.2026 at 15:36.

Titulli	Data dhe Ora
Kërkesë për rishqyrtim	29.05.2026 11:42
Dokumenti Shtojca	29.05.2026 11:43
Vendimi i AK në Kërkesën për rishqyrtim	08.12.2025 15:26
Vendimi i AK në Kërkesën për rishqyrtim	17.12.2025 14:05
Vendimi i AK në Kërkesën për rishqyrtim	04.06.2026 15:36

**vendimi i ak date 04.06.2026 ora 15:36 dita e 4 e punes**

**Prova 4:** Vendimi i Autoritetit Kontraktues për kërkesën për rishqyrtim, i datës **04.06.2026**. ne eprokurim

## **Pretendimi nr. 143**

### **Mospezullimi i aktivitetit të prokurimit**

GOE Ankues pretendon se Autoriteti Kontraktues ka vepruar në kundërshtim me **nenin 108/A të LPP-së dhe nenin 61.1 të Rregullores Nr.001/2022 për Prokurimin Publik**, pasi pas parashtrimit të kërkesës për rishqyrtim nuk e ka pezulluar aktivitetin e prokurimit.

Sipas **nenit 61.1 të Rregullores Nr.001/2022**, parashtrimi i kërkesës për rishqyrtim **automatikisht pezullon procedurën e prokurimit**, ndërsa Autoriteti Kontraktues/Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit duhet t'i njoftojë me shkrim të gjitha palët lidhur me pezullimin.

Në rastin konkret, GOE Ankues ka parashtruar kërkesë për rishqyrtim, mirëpo Autoriteti Kontraktues nuk e ka pezulluar aktivitetin në platformën **e-prokurimi** dhe nuk ka njoftuar palët për pezullim.

Ky mosveprim ka cenuar sigurinë juridike dhe efektivitetin e mjetit juridik të GOE Ankues.

### **Kërkesë**

GOE Ankues kërkon nga OSHP që të konstatojë se Autoriteti Kontraktues ka vepruar në kundërshtim me **nenin 108/A të LPP-së dhe nenin 61.1 të Rregullores Nr.001/2022**, duke mos pezulluar aktivitetin e prokurimit pas parashtrimit të kërkesës për rishqyrtim.

## **Pretendimi nr. 1**

### **– Mosdhënia e qasjes së plotë në dokumentacionin zyrtar**

- Më datë **26.05.2026**, gjatë qasjes së mundësuar nga AK, kemi pranuar dy CD:
  - Njëra CD përmbante dokumentacionin e OE-së së shpallur fitues;
  - CD-ja tjetër ka rezultuar e zbrazur, pa dokumentacionin e operatorëve ekonomikë të tjerë që kanë ofertuar me çmim më të ulët se oferta jonë dhe/ose janë renditur para nesh.
- Edhe pse kemi përsëritur kërkesën për qasje, deri në ditën e fundit të afatit për rishqyrtim AK nuk ka mundësuar qasje të plotë.

### **Kërkesa e Përsëritur për Ri-qasje në E-prokurim**

**Për: Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit**

**Lënda: Kërkesë e përsëritur për qasje të plotë në dokumente zyrtare të aktivitetit të prokurimit**

Aktiviteti i prokurimit: Ndërtimi i Çerdhës në lagjen MATI-1, Prishtinë

Nr. i prokurimit: 208-25-10238-5-1-1

Nr. i brendshëm: 208025032511

Të nderuar,

Ne, OE "Nnp Cta" sh.p.k., si operator ekonomik pjesëmarrës në aktivitetin e prokurimit të cekur më lart, paraqesim këtë kërkesë të përsëritur për qasje në dokumente zyrtare, pasi qasja e mundësuar sot nuk ka qenë e plotë dhe nuk na ka mundësuar verifikimin e ligjshmërisë së procesit të vlerësimit dhe krahasimit të ofertave.

Më datë 26.05.2026, gjatë qasjes së mundësuar nga Autoriteti Kontraktues, na janë dorëzuar dy CD. Në njërin CD kanë qenë të vendosura dokumentet e OE/grupit të operatorëve ekonomik të shpallur fitues, ndërsa CD-ja tjetër ka rezultuar e zbrazur, pa dokumentacionin e operatorëve ekonomik të tjerë që kanë pasur ofertë më të lirë se oferta jonë dhe/ose janë renditur para nesh në renditjen financiare.

Për këtë arsye, konsiderojmë se qasja e dhënë nuk ka qenë qasje e plotë në dokumentacionin zyrtar të aktivitetit të prokurimit. Qasja vetëm në dokumentacionin e OE të shpallur fitues nuk është e mjaftueshme për të verifikuar nëse vlerësimi, eliminimi, pranimi ose refuzimi i operatorëve ekonomik të renditur para nesh është bërë në përputhje me Dosjen e Tenderit, Njoftimin për Kontratë, Ligjin për Prokurimin Publik dhe rregullat përkatëse të prokurimit publik.

Kërkesa jonë bazohet në nenin 10 të Ligjit për Prokurimin Publik, që rregullon qasjen në dokumente zyrtare, si dhe në nenin 11 të LPP-së, që rregullon klasifikimin e informatave sekrete afariste. Nëse ndonjë pjesë e dokumentacionit konsiderohet sekret afarist, kërkojmë që Autoriteti Kontraktues të përgatisë versionin e pastruar të dokumenteve dhe të na mundësojë qasje në pjesët e lejuara, ndërsa çdo kufizim eventual të arsyetohet qartë, konkretisht dhe mbi bazë ligjore.

**Andaj, kërkojmë që Autoriteti Kontraktues të na mundësojë edhe njëherë qasje të plotë në dokumentacionin zyrtar, përkatësisht:**

- Ofertat dhe dokumentacionin përkatës të të gjithë operatorëve ekonomik që janë renditur me çmim më të ulët se oferta jonë ose para nesh në renditjen financiare;
- Arsyetimin e Autoritetit Kontraktues për pranimin, refuzimin ose eliminimin e operatorëve ekonomik të renditur para nesh;
- Raportin dhe procesverbalet e vlerësimit të tenderëve;
- Dokumentet administrative, profesionale, teknike dhe financiare të OE/grupit të operatorëve ekonomik të shpallur fitues, në versionin e lejuar për qasje;
- Dëshmitë për përmbushjen e kriterëve të përshtatshmërisë, kriterëve të përzgjedhjes dhe specifikimeve teknike;
- Formularët, deklaratat, autorizimet, marrëveshjet e grupit të operatorëve ekonomik dhe dokumentet tjera të kërkuara në Dosjen e Tenderit;
- Çdo vendim, sqarim, komunikim ose dokument tjetër mbi të cilin Autoriteti Kontraktues ka bazuar vlerësimin, krahasimin dhe vendimin për dhënie të kontratës.

Po ashtu, kërkojmë që të mbahet procesverbal për qasjen e radhës, ku do të evidentohet saktësisht dokumentacioni i vënë në dispozicion, si dhe të sqarohet zyrtarisht arsyeja pse CD-ja e dytë e dorëzuar sot ka qenë e zbrazur.

Ju lutemi që sa më parë të na njoftoni për datën, orën dhe vendin ku do të na mundësohet qasja e plotë në dokumentacionin zyrtar të këtij aktiviteti të prokurimit.

Me respekt,

OE "Nnp Cta" sh.p.k.

26.05.2026

**Kërkesa e Përsëritur për Ri-qasje në gmail**



Nnp Cta <nnpcta@gmail.com>

### KERKESE URGJENTE

1 message

Nnp Cta <nnpcta@gmail.com>  
To: Xhemajl.Buzuku@rks-gov.net


Tue, May 26, 2026 at 1:26 PM

Të nderuar,

Bashkëngjitur po ju dërgojmë kërkesën e përsëritur për qasje në dokumente zyrtare lidhur me aktivitetin e prokurimit "Ndërtimi i Çerdhes në lagjen M ATI-1, Prishtinë", me nr. të prokurimit 208-25-10238-5-1-1.

Kërkesa paraqitet pasi gjatë qasjes së mundësuar sot na janë dorëzuar dy CD, ku njëra përmbante dokumentet e OE të shpallur fitues, ndërsa CD tjetër ishte e zbrazur dhe nuk përmbante dokumentet e OE-ve tjerë të renditur para nesh / me ofertë më të lirë se oferta jonë.

Me respekt,  
idn. ZIJA MORINA



e-mail: [nnpcta@gmail.com](mailto:nnpcta@gmail.com)




<https://mail.google.com/mail/u/0/?ik=74830321b1&view=pt&search=all&permthid=thread-a.r5001565154392983812&siml=msg-a.r782839463738908503>


1/1

## Shtojcë: Dëshmi fotografike

Fotografitë e bashkangjitura paraqesin CD-në me dokumente dhe CD-në e zbrazur të dorëzuar gjatë qasjes së datës 26.05.2026.



Dëshmi 1: CD me dokumentacion të OE/grupit të shpallur fitues.



Dëshmi 2: CD e zbrazur, pa dokumentacion.

- Dëshmitë fotografike të bashkangjitura (CD me dokumentacionin e OE fitues dhe CD e zbratur) provojnë pamundësinë e verifikimit të ligjshmërisë së procesit.

### Shkeljet nga ana e AK

- **Neni 10 LPP:** garanton qasje në dokumentacionin zyrtar. Mosdhënia e qasjes së plotë është shkelje direkte e këtij neni.
- **Neni 7 LPP:** kërkon transparencë dhe trajtim të barabartë. Duke mos dhënë dokumentet e OE-ve më të lirë, AK ka cenuar barazinë në trajtim dhe transparencën e procedurës.
- **Neni 59 LPP:** obligon AK që ekzaminimi, vlerësimi dhe krahasimi i tenderëve të bëhet në mënyrë të dokumentuar dhe të arsyetuar. Pa qasje në dokumentet e OE-ve më të lirë, nuk mund të verifikohet ligjshmëria e këtij procesi.
- **Neni 19.16 Rregullore 002/2024:** kërkon që specifikimet teknike dhe dokumentet të hartohen me deklaratë nën betim, duke garantuar se nuk favorizojnë ose diskriminojnë OE-të. Pa qasje, nuk mund të kontrollohet nëse ky nen është respektuar.
- **Neni 7.6.2 dhe 7.6.3 Rregullore 002/2024:** obligojnë AK të përgatisë versionin e pastruar të dokumenteve dhe të mbajë procesverbal për qasjen. Këto detyrime nuk janë respektuar.

### Kërkesë ndaj AK-së

1. Ta aprovojë këtë pretendim si të bazuar;
2. Ta anulojë vendimin për dhënie të kontratës;
3. Ta kthejë lëndën në rivlerësim;
4. Para rivlerësimit, të na mundësojë qasje të plotë në dokumentacionin e OE-ve me çmim më të ulët se oferta jonë dhe/ose të renditur para nesh, duke përfshirë ofertat, arsyetimet për pranimin/refuzimin, raportet e vlerësimit dhe çdo dokument tjetër mbi të cilin është bazuar vendimi i AK-së.

**Pretendimet nga nr.2-8 sa i përket GOE-së së shpallur fitus "AC-ing" SH.P.K. & "Decon" SH.P.K.,**

### **Pretendimi nr. 2**

#### **Kërkesa e AK-së tek Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale**

AK në pikën 8 ka kërkuar që OE të dorëzojë listën e stafit me **së paku 40 punëtorë**, ku disa prej tyre duhet të jenë personel teknik i kualifikuar dhe punëtorë të trajnuar.

Sipas Dëshmisë 8, **lista e punëtorëve duhet të dorëzohet origjinal** ose kopje e noterizuar, **së bashku me kontrata ose parakontrata mbi marrëdhënien e punës**, listë të projekteve të evidentuar dhe të nënshkruar, diploma për personelin teknik dhe certifikata trajnimi për punëtorët e trajnuar.

OE i shpallur fitues ka paraqitur listë me vetëm **30 persona**, jo **40**. Kjo listë nuk e arrin minimumin e kërkuar nga AK.



Emri i AK: **MINISTRIA E ARSIMIT**

Adresa e AK: RR..AGIM RAMADANI NR.1- Qyteti: PRISHTINË

Titulli: **Ndërtimi i Çerdhes në lagjen M ATI-1. Prishtinë**

Numri i prokurimit: 208-25-10238-5-1-1; Numri i brendshëm: 208025063511

**LISTA E STAFIT**

<b>Pozita</b>	<b>Emri dhe Mbiemri</b>	<b>Vitet e përvojës në përgjithësi</b>	<b>Vitet e përvojës në pozitat e propozuara</b>
1. Menaxher kryesor i projektit	Ing. Ndërt.Arton Cocaj	20	18
2. Menaxheri kryesor i punishtes për poz. e arkitekturës	Ing.dip.ark. Fidan Belegu	15	9
3. Menaxher kryesor i punishtes për instalime elektrike - Inxhinier (master) i diplomuar i elektroteknikes drejtimi elektroenergetikë	Ing. Elek.Zenel Dinaj	30	27
3. Menaxher kryesor i punishtes për instalime elektrike - Inxhinier (master) i diplomuar i elektroteknikes drejtimi elektroenergetikë (i certifikuar për eficienc te energjisë, ekspert i siguris dhe shëndetit në pun nga MPMS dhe mbrojtje nga zjarri nga AME)	Ing. Elek.Murat Hoxha	22	19
4.Menaxher kryesor i punëve makinerie-Inxhinier (master) i diplomuar i Makinerisë	Ing. Mak.Raman Rexhepi	35	31
5. Menaxher kryesor i punimeve për instalime hidroteknike - Inxhinier (master) i diplomuar i Ndërtimitares , drejtimi Hidroteknikë	Ing. Ndërt.Hidro. Vehbi Duraku	20	8
5.1 Inxhinier (master) i diplomuar i Xehetarisë , me pesë vite përvojë pune i licencuar dhe i certifikuar si ekspert i siguris dhe shëndetit në punë nga MPMS dhe mbrojtje nga zjarri nga AME.	Ing.xeh. Mehdi Mirena	30	19
5.2 Bachelor I Arteve ne Menaxhimin e Emergjencave, me pesë vite përvojë pune i	Bach.emergj. Emin Mirena	25	10

licencuar dhe i çertifikuar si ekspert i siguris dhe shëndetit në punë nga MPMS dhe mbrojtje nga zjarri nga AME.			
6.Menaxher kryesor i punëve ndërtimore - Inxhinier (master) i diplomuar i arkitekturës.	Ing. ark. Florina Orana - Hoxha	33	31
7.Menaxher kryesor i punishtes për gjeodezi- Gjeodet i licencuar	Inxh. i Dipl.i Gjeo. Xhavit Fetahu	15	10
Inxhinier (master) i diplomuar i Ndërtimtarisë, drejtimi Konstruktivë	Ing. Ndërt.Muharrem Veseli	13	7
Teknik i Ndërtimtarisë	Burim Qelaj	18	7
Teknik e Arkitekturës	Shyhrete Veseli	16	10
Teknik i Hidronëdërtimtarisë	Faton Bunjaku	20	18
Teknik i Elektrikes	Naim Haxhija	20	15
Teknik i Makinerisë	Bashkim Haxhija	20	6
Armirues	Bashkim Emiri	23	7
Latues	Berat Sylejmani	25	10
Murator	Shkumbin Veseli	7	5
Suvatuese	Valdet Smakaj	5	5
Manipulues i makinerisë	Bujar Dobruna	10	8
Manipulues i makinerisë	Ikbal Radheshi	25	19
Skelistë	Hamzë Smakaj	8	8
Kranist	Sefedin Rudi	19	8
Kranist	Besmir Veseli	8	8
Zdrukhëtar (Përpunues Druri)	Bekim Hajdini	15	7
Instalues te ngrohjes dhe klimatizimit	Rrahim Sogojeva	12	12
Instalues te ngrohjes dhe klimatizimit	Blend Topojani	5	3
Instalues elektrik	Armend Haxhijaj	15	8
Teknik IT (Kompjuterik)	Almir Ajeti	15	10

"AC ing"Sh.p.k



Për më tepër, edhe kjo listë prej 30 personave nuk është e mbuluar plotësisht me dëshmitë e kërkuara, sepse për **Blend Topojani** nuk është dorëzuar fare as kontratë pune, as parakontratë, as kontratë për kryerje të shërbimeve.

### **Lista e stafit të paraqitur nga OE dhe lloji i dëshmisë**

<b>Nr.</b>	<b>Emri dhe mbiemri</b>	<b>Pozita</b>	<b>Çka shihet në dosje</b>
1	Arton Cocaj	Menaxher kryesor i projektit	Kontratë pune për kohë të caktuar
2	Fidan Belegu	Arkitekt	Kontratë për kryerje të shërbimeve
3	Zenel Dinaj	Inxhinier elektrik	Kontratë pune për kohë të caktuar
4	Murat Hoxha	Inxhinier elektrik	Kontratë për kryerje të shërbimeve
5	Raman Rexhepi	Inxhinier makinerie	Kontratë pune për kohë të caktuar
6	Vehbi Duraku	Inxhinier hidroteknik	Kontratë pune për kohë të caktuar
7	Mehdi Mirena	Ekspert sigurie / zjarr	Kontratë për kryerje të shërbimeve
8	Emin Mirena	Menaxhim emergjencash	Kontratë për kryerje të shërbimeve
9	Florina Orana-Hoxha	Arkitekthe	Kontratë pune për kohë të caktuar
10	Xhavit Fetahu	Gjeodet	Kontratë për kryerje të shërbimeve
11	Muharrem Veseli	Inxhinier konstruktiv	Kontratë pune për kohë të pacaktuar
12	Burim Qelaj	Teknik ndërtimtarie	Kontratë për kryerje të shërbimeve
13	Shyhrete Veseli	Teknike arkitekture	Kontratë pune për kohë të caktuar
14	Faton Bunjaku	Teknik hidro	Kontratë pune për kohë të caktuar
15	Naim Haxhija	Teknik elektrik	Kontratë për kryerje të shërbimeve
16	Bashkim Haxhija	Teknik makinerie	Kontratë për kryerje të shërbimeve
17	Bashkim Emini	Armirues	Kontratë për kryerje të shërbimeve
18	Berat Sylejmani	Latues	Kontratë për kryerje të shërbimeve
19	Shkumbin Veseli	Murator	Kontratë pune për kohë të caktuar
20	Valdet Smakaj	Suvatuese	Kontratë pune për kohë të caktuar
21	Bujar Dobruna	Manipulues makinerie	Kontratë pune për kohë të caktuar
22	Ikbal Radheshi	Manipulues makinerie	Kontratë për kryerje të shërbimeve
23	Hamzë Smakaj	Skelist	Kontratë pune për kohë të caktuar
24	Sefedin Rudi	Kranist	Kontratë për kryerje të shërbimeve
25	Besmir Veseli	Kranist	Kontratë për kryerje të shërbimeve
26	Bekim Hajdini	Përpunues druri	Kontratë për kryerje të shërbimeve
27	Rrahim Sogojeva	Instalues ngrohje/klimatizim	Kontratë për kryerje të shërbimeve
28	Blend Topojani	Instalues ngrohje/klimatizim	Nuk ka kontratë, nuk ka parakontratë dhe nuk ka kontratë për shërbime
29	Armend Haxhijaj	Instalues elektrik	Kontratë për kryerje të shërbimeve

Nga lista e mësipërme rezulton se OE ka paraqitur vetëm **30 persona**, ndërsa AK ka kërkuar së paku **40 punëtorë**. Pra, mungojnë **10 punëtorë** për përmbushjen e minimumit të kërkuar.

Nga 30 personat e paraqitur, për **Blend Topojani** nuk është dorëzuar fare asnjë dëshmi kontraktuale. Rrjedhimisht, edhe në interpretimin më të favorshëm për OE, numri maksimal i personave të mbuluar me ndonjë formë kontrate është **29 persona**, që është dukshëm nën minimumin prej **40 punëtorëve** të kërkuar nga AK

Në dosje figurojnë listat e pagave të ATK-së të kompanisë, mirëpo **mungojnë kontratat / parakontratat mbi marrëdhënien e punës për punëtorët/stafin**, ashtu siç është kërkuar në dosjen e tenderit. Prandaj, vetëm listat e pagave nuk janë të mjaftueshme për plotësimin e kërkesës së Dëshmisë 8.

Me pranimin e kësaj oferte si të përgjegjshme, AK ka vepruar në kundërshtim me:

**Nenin 59 paragrafi 4 të LPP-së**, sepse tenderi mund të konsiderohet i përgjegjshëm vetëm nëse është në përputhje me të gjitha kërkesat e njoftimit për kontratë dhe dosjes së tenderit. Në rastin konkret, OE nuk ka dëshmuar minimumin prej 40 punëtorëve dhe nuk ka dorëzuar dokumentet e kërkuara mbi marrëdhënien e punës.

**Nenin 60 të LPP-së**, sepse kontrata mund t'i jepet vetëm operatorit ekonomik që ka dorëzuar tender të përgjegjshëm.

**Nenin 7 të LPP-së**, sepse pranimi i një OE që nuk i plotëson kërkesat minimale cenon trajtimin e barabartë dhe transparencën ndaj OE-ve të tjerë.

GOE

**Andaj, oferta e GOE të shpallur fitues është dashur të shpallet e papërgjegjshme**, për shkak të mosdorëzimit të **40 punëtorëve së bashku me kontrata ose parakontrata mbi marrëdhënien e punës**, të kërkuar nga AK në dëshminë 8.

### **Pretendimi nr. 3**

**Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale -Mosdorëzimi i listës së veçantë të pajisjeve**

Autoriteti Kontraktues, në **Dëshminë 11**, ka kërkuar që OE të dorëzojë **listën e mjeteve mbi pronësinë apo marrjen me qira të mjeteve, stabilimenteve, pajisjeve teknike dhe kapaciteteve tjera të nevojshme për realizimin e projektit**. Kjo listë është kërkuar të jetë **origjinale, e nënshkruar dhe e vulosur nga Operatori Ekonomik**.

Mirëpo, sipas **Formularit B66 – Lista e dokumenteve të tenderit mbështetëse**, OE i shpallur fitues nuk ka dorëzuar dokument me emërtimin **“Lista e pajisjeve”, “Lista e mjeteve”** apo **“Lista e**

**mjeteve/pajisjeve**". Në B66 figurojnë kryesisht kontrata/marrëveshje për pajisje, si dhe dokumenti **"19.0 AC ING - PAISJET.pdf"**, por nuk figuron lista e veçantë e kërkuar nga AK.

**Prokurimi: 208-25-10238-5-1-1**

**Nr i brendshëm:**

**Titulli: Ndërtimi i Çerdhes në lagjen M ATI-1. Prishtinë**

**1 Ndërtimi i Çerdhes në lagjen M ATI-1. Prishtinë**

**Kodi i tenderit: 208-25-10238-5-1-1**

**Data: 19.12.2025**

**Lista e dokumenteve të tenderit mbështetëse**

---

<b>Nr.</b>	<b>Dokument</b>
1.	1.0 MARRËVESHJE_DEKLARATE per formimin e grupit .2024 - .pdf
2.	2.0 Aneksi 2 DEKLARATA NËN BETIM.pdf
3.	3.0 Certifikata e noterizuar ARBK & Numri fiskal.pdf
4.	4.0 CD-Raportet e auditimit -2021-2022 -2023-2024.rar
5.	4.1 CD-Raportet e auditimit -2021-2022 -2023-2024.rar
6.	5.0 Lista e stafit-AC ING Sh.p.k_compressed.pdf
7.	5.1 Lista e stafit-AC ING Sh.p.k_compressed.pdf
8.	5.2 Lista e stafit-AC ING Sh.p.k_compressed.pdf
9.	5.3 Lista e stafit-AC ING Sh.p.k_compressed.pdf
10.	5.4 Lista e stafit-AC ING Sh.p.k_compressed.pdf
11.	5.5 Lista e stafit teknik-AC ING Sh.p.k_compressed.pdf
12.	5.6 Lista e stafit teknik-AC ING Sh.p.k.pdf
13.	5.7 Lista e stafit teknik-AC ING Sh.p.k_compressed.pdf
14.	5.8 Lista e stafit teknik-AC ING Sh.p.k_compressed.pdf
15.	5.9 Lista e stafit teknik-AC ING Sh.p.k.pdf
16.	6.0 Vlerësimi i riskut nga një kompani e licencuar nga MPMS.pdf
17.	7.0 Lista e Projekteve-AC ing Shpk-2022-2025_compressed.pdf
18.	8.0 Lista e Projekteve-DECON Shpk-2022-2025.pdf
19.	9.0 KONTRAT PER MARRVESHJE-Golding sh.p.k.pdf
20.	10.0 KONTRAT PER MARRVESHJE -AL VA PARTNERS_compressed.pdf
21.	11.0 KONTRAT PER MARRVESHJE -EURO KRAN.pdf
22.	11.1.pdf
23.	12.0 KONTRAT PER MARRVESHJE - 3D-FESALL.pdf
24.	13.0 KONTRAT PER MARRVESHJE -Pro ENG.pdf
25.	14.0 KONTRAT PER MARRVESHJE -Metra construction.pdf
26.	15.0 Marrveshja me Garden Bau Kastrati.pdf
27.	16 .0 KONTRAT PER MARRVESHJE - Shemi N. Aliu B.I.pdf
28.	17.0 KONTRAT PER MARRVESHJE-Seferi-CO Shpk.pdf
29.	18.0 KONTRAT PER MARRVESHJE - RIFA SH.P.K.pdf
30.	19.0 AC ING -PAISJET.pdf
31.	20.0 Sigurimi i Tenderit.pdf

**Përshkrimi i çmimeve**

---

Po ashtu, edhe pas kontrollimit të dokumenteve të dorëzuara si dëshmi, nuk evidentohet listë e veçantë e pajisjeve, origjinale, e nënshkruar dhe e vulosur nga OE. Dokumentet e dorëzuara janë

kryesisht **kontrata/marrëveshje qiraje**, ku pajisjet përmenden vetëm brenda tekstit të marrëveshjeve, si te AL VA PARTNERS, 3D-FESALI dhe GARDEN BAU KASTRATI etj.

Ndërsa dokumenti **“19.0 AC ING - PAISJET.pdf”** përmban fatura dhe dëshmi të transaksioneve bankare për pajisje të caktuara, por nuk paraqet listë të veçantë të pajisjeve sipas kërkesës së AK-së.

Kontratat/marrëveshjet e qirasë dhe faturat mund të shërbejnë si dëshmi për pronësi apo qira, por nuk e zëvendësojnë **listën e veçantë të pajisjeve**, e cila është kërkuar shprehimisht nga AK si dokument më vete.

Me pranimin e kësaj oferte si të përgjegjshme, AK ka vepruar në kundërshtim me

**\*nenin 59 paragrafi 4 të LPP-së**, pasi oferta e OE të shpallur fitues nuk është në përputhje me kërkesat e Dosjes së Tenderit, konkretisht me Dëshminë 11. Gjithashtu, është cenuar edhe

**\*neni 69 i LPP-së**, pasi lista e pajisjeve përbën dëshmi të aftësisë teknike/profesionale, si dhe

**\*neni 7 i LPP-së**, për shkak të trajtimit jo të barabartë të operatorëve ekonomikë.

AK ka vepruar edhe në kundërshtim me **nenin 40.2 të Rregullores Nr. 001/2022**, pasi vlerësimi duhet të bëhet në pajtim me kërkesat e përcaktuara në Dosjen e Tenderit dhe Njoftimin për Kontratë.

**Andaj, oferta e OE të shpallur fitues është dashur të shpallet e papërgjegjshme**, për shkak të mosdorëzimit të listës së veçantë të pajisjeve sipas Dëshmisë 11.

#### **Pretendimi Nr. 4**

#### **Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale 9.1 & 9.2**

Pika 5 AK ka kërkuar . Menaxher i punimeve për instalime hidroteknike kërkohet të jetë Inxhinier (master) i diplomuar i Ndërtimtarisë , drejtimi Hidroteknikë, me pesë vite përvojë pune në fushën e instalimeve hidroteknike ose të ngjashme, i licencuar dhe i certifikuar si ekspert i sigurisë dhe shëndetit në punë nga MPMS dhe mbrojtje nga zjarri nga AME. - Ndërsa çështja e certifikatës së ekspertit të sigurisë dhe shëndetit në punë dhe certifikatën për mbrojtje nga zjarri nga AME, OE mund ta dëshmojë nga cilido inxhinier i fushave të ndryshme apo stafit teknik që kompania posedon

Dëshmia 1-7. Për menaxherin e projektit, menaxheret kryesor të punishtës të paraqiten vendimet për përcaktimin e menaxherit të projektit dhe menaxheret e punishtës, diplomat përkatëse dhe Certifikatat. Nëse diploma është e lëshuar nga ndonjë shtet tjetër, e njëjta duhet të jetë e nostrifikuar nga MASHTI. **Kopjet e kontratave ose para kontratave mbi marrëdhënien e punës**, listën e projekteve që ka menaxhuar dhe CV-t e tyre të nënshkruar nga vetë personi, letër referencë për vitet dhe lëmin e kërkuar të lëshuar nga punëdhënësit pas diplomimit

G.Operatorve ekonomik i rekomanduar për kontratë nuk ka dëshmuar disponueshmërinë e stafit profesional për kohëzgjatjen e plotë të kontratës. Sipas dosjes së tenderit, pika 5.2, afati i realizimit të kontratës është **36 muaj**. Ndërsa personi i paraqitur si staf profesional, **Vehbi Duraku**, në pozitën **Inxhinier i Ndërtimtarisë-Hidros**, ka kontratë pune me kohe të caktuar me **“AC ing” SH.P.K.** vetëm për periudhën **15.09.2025 – 15.09.2026**.

Kjo kontratë pune nuk e mbulon afatin 36-mujor të kontratës publike dhe nuk dëshmon se i njëjti do të jetë i disponueshëm gjatë tërë periudhës së realizimit të projektit. Në mungesë të një **aneksi, kontrate të re** apo ndonjë dokumenti tjetër që e mbulon periudhën e plotë të kontratës, dëshmia e paraqitur mbetet e pamjaftueshme.

Prandaj, oferta e operatorit ekonomik të rekomanduar duhet të konsiderohet **e papërgjegjshme**, pasi nuk dëshmon përmbushjen e kërkesave teknike/profesionale lidhur me stafin profesional për tërë kohëzgjatjen e kontratës.

#### **ak ka shkelur**

- **Neni 59.4 i LPP-së** – oferta e OE të shpallur fitues nuk është në përputhje me kërkesat e Dosjes së Tenderit dhe njoftimit për kontratë.
- **Neni 69 i LPP-së** – përmbushja e kriterëve teknike/profesionale
- **Neni 40.13 i Rregullores 001/2022 AK** do t'i vlerësojë dhe krahasojë tenderët e përgjegjshëm sipas kriterëve për dhënien e kontratës të përcaktuara në njoftimin e kontratës / dosjen e tenderit.

**Andaj, oferta e OE të shpallur fitues është dashur të shpallet e papërgjegjshme**, për shkak kërkeses së dosjes së tenderit, pika 5.2, afati i realizimit të kontratës është **36 muaj**.

#### **Pretendimi nr. 5**

#### **Kërkesa e Autoritetit Kontraktues -Makineria Be pajisjeve**

ka kërkuar që Operatori Ekonomik të dëshmojë disponimin e: **Kamionit me vinç minimum 14 m për transport**, si dhengritësit automatik me vakum për xhama.

Sipas kërkesës së AK-së, si dëshmi janë kërkuar **lista e pajisjeve** dhe **dëshmia mbi pronësinë ose marrjen me qira të pajisjeve**.

**GOE** ka dorëzuar dokumentacion për pajisjet e lartcekura, duke përfshirë marrëveshjen me **Metra Construction**, dokumentet e automjeteve ku figuron edhe **DECON Sh.p.k.**, si dhe fotografi ku shihet kamioni me vinç/kran dhe pajisja vakum për xhama.

Mirëpo, nga dokumentacioni i dorëzuar nuk dëshmohet qartë se vinçi/krani i kamionit e plotëson kërkesën minimale prej **14 m gjatësi**, ashtu siç është kërkuar në dosjen e tenderit.

Kërkesa e AK-së nuk ka qenë vetëm të dëshmohet ekzistenca apo disponimi i një kamioni me vinç/kran, por edhe të dëshmohet se vinçi/krani i plotëson karakteristikat teknike të kërkuara, konkretisht gjatësinë minimale prej **14 m**.

Andaj, oferta e OE-së së shpallur fitues nuk është dashur të shpallet e përgjegjshme pa kërkuar paraprakisht informata apo sqarime shtesë lidhur me atë se a e plotëson vinçi/krani kërkesën minimale prej 14 m.

Nëse OE do të dorëzonte dëshmi të qartë me dokumentacion teknik, certifikatë, katalog, specifikim teknik të mjetit të vinçi/krani ka **gjatësi minimale 14 m**, atëherë AK do të mund ta konsideronte këtë kriter si të përmbushur.

Në mungesë të një dëshmie të tillë, shpallja e ofertës si e përgjegjshme është e pabazuar dhe jo në përputhje me kërkesat e dosjes së tenderit dhe njoftimit për kontratë.

### **Pretendimi nr. 6**

#### **Kërkesa e Autoritetit Kontraktues -Makineria Be pajisjeve**

##### **Krani statik me gjatësi të krahut mbi 40 m**

Autoriteti Kontraktues ka përcaktuar në dosjen e tenderit dhe njoftimin për kontratë që Operatori Ekonomik duhet të dëshmojë disponimin e një **krani statik me lartësi të mjaftueshme për objektin dhe me gjatësi të krahut mbi 40 metra**. Për mjetet e kategorisë B, si forma të pranueshme dëshmie janë paraparë: **DUD doganor, faturë me transaksion bankar ose kontratë/marrëveshje qiraje**.

- OE ka dorëzuar marrëveshje qiraje me kompaninë 3D-FESALI Sh.p.k., ku figuron pajisja “kran statik”.
